



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, gusht 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi-Hashani, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ardita Salihu dhe Mehmet Muçaj udhëheqës i ekipit, Fjolla Bakalli- Sadiku, Mimoza Morina-Kelani, Flore Berisha dhe Amire Rafuna anëtarë të ekipit, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	33
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	36

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) për vitin 2019, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të MPJ-së të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2019, që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosjet për këto pasqyra, janë të plota dhe të sakta.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në MPJ, nuk kishte funksionuar në nivelin e duhur, dhe si rezultat janë vërejtur mangësi nëpër fusha të ndryshme të cilat duhen të përmirësohen.

Ministria ka përgatitur planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve dhe kishte përshkruar veprimet që do të ndërmerren për zbatimin e tyre, mirëpo implementimi i rekomandimeve nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pa modifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministria është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Çështje Tjera

Shpenzimet në vlerë 4,631,005€, nuk i kemi audituar sepse këto shpenzime ndërlidhen me informata (dokumentet) të klasifikuara me vendim të Kryeministrit.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse MPJ ka vendosur kontrole në raport me obligimet statutores të saj, moszbatimi me konsistencë i rregullave, ka shkaktuar mangësi në procesin e pagesave, menaxhim jo të mirë të pasurive dhe obligimeve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i pagave, avanceve, mallrave dhe shërbimeve, investimeve kapitale dhe pasurive.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimi mit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	32,218,816	31,125,425	29,976,909	96	24,604,204	20,430,293
Granti i Qeverisë - Buxheti	30,218,816	30,550,796	29,549,830	97	24,592,479	20,410,343
Donacionet e brendshme	0	0	0	0	11,725	0
Donacionet e jashtme	0	574,629	427,079	74	0	19,950
Të hyrat nga AKP	2,000,000	0	0	0	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,093,391€. Ky zvogëlim ishte për shkak se të hyrat nga AKP në vlerë 2 milion euro nuk ishin planifikuar si buxhet final si dhe për shkak të rritjes së buxhetit nga donacionet e jashtme në vlerë 574,629€, dhe rritjes nga granti i qeverisë në vlerë 331,980€.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Reali zimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	32,218,816	31,125,425	29,976,909	96	24,604,204	20,430,293
Pagat dhe Mëditjet	7,189,118	7,761,098	7,761,098	100	7,044,411	6,432,342
Mallrat dhe Shërbimet	18,874,647	21,899,276	20,991,840	96	16,560,738	13,268,981
Shërbimet komunale	600,051	600,051	545,228	91	459,380	521,719
Subvencionet dhe Transferet	100,000	50,000	5,500	11	12,877	33,450
Investimet Kapitale	5,455,000	815,000	673,243	83	526,798	173,801

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 571,980€, krahasuar me buxhetin fillestar. Rritja ishte bërë me vendim të qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019, për kursime dhe ndarje buxhetore për ta mbuluar deficitin që kishte ministria në paga në fund të vitit fiskal.

Buxheti final për mallra dhe shërbime krahas buxhetit fillestar ishte rritur për 3,024,629€. Kjo rritje ishte bërë:

- Me vendimin e qeverisë nr. 02/113 të datës 05.11.2019, për kursime dhe ndarje buxhetore ishin ndarë mjete buxhetore në vlerë 1,719,000€;
- Në pajtim me nenin 30 të LMFPP-së, Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e ministrisë për transferin e mjeteve në vlerë 731,000€, nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime;
- Me një rritje nga donacionet e jashtme në vlerë 574,629€.

Buxheti final për subvencione është zvogëluar për 50,000€, krahasuar me buxhetin fillestar. Ndryshimi ishte rezultat i vendimit të Qeverisë me nr. 12/115 të datës 17.12.2019 për kursime dhe ndarje buxhetore.

Buxheti final për investimet kapitale ishte zvogëluar për 4,640,000€, në krahasim me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim ishte bërë:

- Me vendim të Qeverisë nr. 02/113 të datës 05.11.2019 ku ishin bërë kursime buxhetore 2,719,000€;
- Me vendim të Qeverisë 03/115 të datës 17.12.2019 ishin bërë kursime buxhetore prej 308,000€, dhe

- Me vendim të Qeverisë me nr. 12/115 të datës 17.12.2019 ishin bërë kursime buxhetore në vlerë 882,000€.

Më tutje, në pajtim me nenin 30.2 të LMFPF Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e MPJ-së për transferet buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale në kategoritë tjera ekonomike në vlerë 731,000€.

2.1.1 Të hyrat

MPJ për vitin 2019, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 6,170,613€, që krahasuar me vitin paraprak (4,498,318€) kishte një rritje prej 1,672,295€. Rritja e të hyrave ishte si rezultat i rritjes së të hyrave nga taksat për dokumente të udhëtimit dhe rritjes së të hyrave nga vulat apostile dhe të hyrat nga taksat tjera.

Të hyrat realizohen nga taksa për dokumente të udhëtimit, taksa për verifikim të dokumenteve, taksa për letërnjoftim, taksa për shtetësi, taksa për vulë apostile dhe taksa tjera. Kemi testuar 33 mostra për teste substanciale në vlerë 1,800€ dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nuk kemi hasur në ndonjë mangësi në këtë fushë.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetjake	6,170,613	4,498,318	3,153,732
Totali	6,170,613	4,498,318	3,153,732

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2019, ishte 7,761,098€ të cilat ishin shpenzuar në tërësi. Kemi testuar 74 mostra për teste substanciale në vlerë 137,570€, dhe 17 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A1 - Emërimi i Konsujve në Misione Diplommatike konsullore pa konkurs të hapur**Gjetja**

Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës specifikon: “Pranimi në shërbimin e jashtëm bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, në pajtim me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplommatik dhe legjislacionin në fuqi”. Neni 8 paragrafi 1.1 i Rregullores QRK - Nr. 04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm përcakton: “Komisioni ka për detyrë të bëjë Gradimin e Anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe Gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultateve të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë Rregullore.”.

Më tutje, neni 3 paragrafi 3.1 i Udhëzimit Administrativ 02/2012 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidatëve për Nëpunës të Misionit Diplommatik specifikon: “Ministria e Punëve të Jashtme shpall postet vakante për nëpunës në misionin diplommatik përmes konkursit të hapur, i cili zgjatë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike”. Po ashtu, neni 3 paragrafi 3.2 specifikon: “Ministri nxjerrë vendimin për shpalljen e konkursit të hapur”. I njëjtin Udhëzim përcakton procedurat e aplikimit, testimin dhe intervistimit të kandidatëve në pozitë vakante për drejtues të misionit konsullor dhe nëpunës tjerë konsullorë.

Përgjatë vitit 2019, në Misione të ndryshme Diplommatike Konsullore të Kosovës me vendime të Ministrit të MPJ-së ishin emëruar tre konsuj që nuk ishin anëtarë të shërbimit të jashtëm, pa konkurs dhe pa kaluar përmes komisionit të gradave ashtu siç përcaktohet me rregullore.

Kjo kishte ndodhur nga papërgjegjësia e ministrisë për t’i ndjekur dhe respektuar kërkesat e përcaktuara ligjore.

Ndikimi

Emërimi i konsujve pa konkurs dhe pa kaluar përmes komisionit të gradave, ua pamundëson aplikimin qytetarëve tjerë të interesuar për këtë pozitë, ndikon në dëmtimin e transparencës, si dhe mund të ndikoj që kandidatët e përzgjedhur të jenë jomeritor dhe jo kompetent për këtë pozitë.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj që me rastin e emërimit të përfaqësuesve në Misione diplommatike konsullore, pranimi të bëhet përmes konkursit të hapur duke respektuar gjithashtu edhe kërkesën ligjore për gradimin e anëtarëve që hyjnë në shërbimin e jashtëm.

Çështja A2- Pranimi i konsujve me vendim të ministrit jo në pajtim me kërkesat ligjore**Gjetja**

Neni 8 i Udhëzimit Administrativ 02/2012 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidatëve për Nëpunës të Misionit Diplomatik specifikon: “Pas intervistimit, paneli intervistues harton një listë të kandidatëve, që fillon me kandidatët me numrin më të lartë të pikëve të grumbulluara nga provimi me shkrim dhe rezultati i intervistimit nga të gjithë anëtarët e panelit intervistues, dhe kjo listë i përcillet Ministrit të Punëve të Jashtme përmes Sekretarit të Përhershëm. Krahas kësaj dhe duke marrë për bazë këtë renditje, paneli intervistues veçanërisht i rekomandon Ministrit një listë prej të paktën tre (3) kandidatëve për secilin post vakant”. Po ashtu neni 9 i këtij udhëzimi përcakton: “Pas përfundimit të të gjitha procedurave për përzgjedhjen e nëpunësve diplomatik, ashtu siç përcaktohet në nenin 8 të këtij Udhëzimi Administrativ, Ministri nxjerrë vendim për emërimin e nëpunësve diplomatik”. Po ashtu neni 8 paragrafi 1.1 i Rregullores QRK - Nr. 04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm përcakton: “Komisioni ka për detyrë të bëjë Gradimin e Anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe Gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultateve të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë Rregullore.”

MPJ me datën 12.03.2019, kishte shpallur konkurs për pranimin e 15 Zyrtarëve në Misionet Diplommatike. Ne kemi identifikuar se komisioni i vlerësimit me datën 05.07.2019, i kishte propozuar ministrit listën me 15 kandidatët e përzgjedhur me ç’rast ministri me vendim e kishte aprovuar listën e kandidatëve të cilët edhe ishin pajisur me akt emërimi. Më tutje, ministri me vendime kishte emëruar gjashtë (6) konsuj në Misionet Diplommatike të cilët ishin pjesëmarrës në konkursin e lartcekur, mirëpo nuk ishin propozuar nga komisioni përzgjedhës. Të njëjtit nuk kanë kaluar përmes komisionit të gradave.

Kjo kishte ndodhur nga papërgjegjësia e ministrisë për t’i ndjekur dhe respektuar kërkesat e përcaktuara ligjore.

Ndikimi

Emërimi i konsujve pa i ndjek kërkesat e parapara ligjore dhe pa kaluar përmes komisionit të gradave, e pamundëson aplikimin e qytetarëve tjerë të interesuar për këtë pozitë, ndikon në dëmtimin e transparencës, si dhe mund të ndikoj që kandidatët e përzgjedhur të jenë jomeritor dhe jo kompetent për pozitë që e ushtrojnë.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj që me rastin e emërimit të përfaqësuesve në Misionet diplomatike konsullore, të respektohen rregullat e procesit të gradimit.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalit

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2019 ishte 22,499,327€, prej tyre ishin shpenzuar 21,537,068€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e qirave të ambasadave, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, furnizime për zyre, shërbime për sigurime shëndetësore etj.

Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 2,354,625€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A3- Mbulimi i shpenzimeve shëndetësore në mungesë të marrëveshjes për sigurim shëndetësor

Gjetja

Udhëzimi administrativ MPJ nr.04/2015 për Sigurimet Shëndetësore në Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, neni 3 paragrafi 1 përcakton se: Ministria i paguan polisat e sigurimit shëndetësor për përfaqësuesit diplomatikë/konsullorë të Republikës së Kosovës, të akredituar në misionet diplomatike dhe konsullore dhe familjes së tyre të ngushtë.

Në kemi hasur në një rast kur i akredituari (zëvendës konsull) në Konsullatën e Frankfurtit nuk kishte qenë fare i siguruar edhe pse ishte i emëruar që nga muaji mars 2016. Si rrjedhojë, për vitin 2019, Konsullata është detyruar të paguajë 32,564€, për shërbime spitalore për familjen e të akredituarit. Këto fatura që i ishin drejtuar Konsullatës nga spitale të ndryshime, datonin që nga viti 2017.

Sipas disa korrespondencave që ishin bërë ndër vite mes Ministrisë, Konsullatës, Kompanisë së Sigurimeve dhe diplomatit në fjalë mund të konstatojmë se arsyet për mos sigurimin e tij ishin nga më të ndryshmet, duke filluar nga neglizhenca për kryerjen e kontroleve mjekësore dhe mos kompletimin e dokumentacionit sipas kërkesës së kompanisë së sigurimit, përkeqësimi i gjendjes shëndetësore, e deri tek refuzimi i kompanisë së sigurimit për të marrë përsipër sigurimin e tij. Refuzimi ishte bërë për shkak se kompania e kishte vlerësuar si ‘të pabesueshëm’ si dhe i njëjti kishte të listuar obligime të papaguara ndaj palëve tjera në regjistrin “SHUFA”³

Ministri me 28.12.2018 kishte marr vendim që ky diplomat të kthehet nga misioni më datë 30.01.2019 me arsyetimin se tërhiqet për nevoja të punës të Ministrisë. Me datën 29.01.2019 ministri e shfuqizon vendimin për kthim dhe me vendimin e njëjtë e transferon si zëvendës konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Toronto/Kanada, në mandat prej 15.02.2019 deri më 01.03.2020.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave ligjore për pagesën e polisave të sigurimit për përfaqësuesit diplomatik apo konsullorë shkakton pagesa pa bazë ligjore, të cilat mund të dëmtojnë buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë se të gjithë të akredituarit diplomatik, pajisen me polisa të sigurimeve shëndetësore. Për rastet ku mund të krijohen vonesa deri në nënshkrimin e një kontrate, duhet të hartohet një akt nënligjor i cili definon qartë se deri në çfarë vlere/norme mund të mbuloen shpenzimet shëndetësore nga buxheti i shtetit.

³ Schutzgemeinschaft für Allgemeine Kreditsicherung (Komuniteti ose Shoqata mbrojtëse për mbrojnë e përgjithshme të kredive).

Çështja A4- Mbulimi i shpenzimeve për renovime të banesave**Gjetja**

Nenit 4 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (UA) 01/2018 për Plotësimin dhe Ndryshimin e UA nr.03/2012 për Shpenzime Personale dhe Operacionale në Misione Diplommatike, përcakton se: “përgjegjësia për menaxhimin e kontratës së banimit është e anëtarit të personelit të misionit i cili e shfrytëzon atë objekt banimi”.

Konsullata e Kosovës në Frankfurt kishte paguar 11,794€, për kthim të objektit në gjendjen e mëhershme dhe për të mbuluar dëmet e shkaktuara për objektin që shfrytëzohej me qira, nga njëri punonjës diplomatik i këtij misioni.

Këto shpenzime kanë të bëjnë me të njëjtin përfaqësues diplomatik për të cilin ishin shkaktuar shpenzimet shëndetësore në çështjen e mësipërme.

Nga MPJ nuk kemi pranuar ndonjë arsye me shkrim, se pse janë paguar këto shpenzime nga paraja publike.

Ndikimi

Pagesat e tilla për renovime të objekteve të banimit nuk kanë bazë ligjore dhe si të tilla dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të krijoj një komision i cili vlerëson se cilat nga shpenzimet e mësipërme janë bërë nga moskujdesi i diplomatit dhe për të njëjtat duhet t'i bëhen ndalesat në pagë. Në ato raste ku Ministria vlerëson se duhet patjetër të paguajë për renovime, atëherë këtë duhet ta bëjë vetëm nëse harton akt nënligjor ku përcaktohet qartë se deri në çfarë shkalle dhe cilat shpenzime mund të konsiderohen si të domosdoshme për mbulim nga paraja publike.

Çështja A5- Furnizim me pajisje të IT pa pëlqim të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (AShI)**Gjetja**

Neni 6 i Rregullores 06/2018 për Menaxhimin e Projekteve në Fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit përcakton që për inicimin e projektit, institucionet marrin pëlqim paraprak nga AShI dhe kërkesës për pëlqim Institucioni i bashkëngjit idenë e projektit.

Më datë 17.10.2019 MPJ kishte bërë njoftimin për kontratë për furnizim me pajisje të teknologjisë informative 1. (Wireless Controllers (Active Passive) - sipas specifikave teknike të detyrueshme 2 njësi, 2. Access Points (Indoor) - sipas specifikave teknike të detyrueshme 55 njësi, 3. Identity Services Software for Wired Wireless Network - sipas specifikave teknike të detyrueshme 1 njësi, 4. Network Infrastructure Centralized Management (Wired Wireless) - sipas specifikave teknike të detyrueshme 1 njësi, 5. Network Device Auditing Solution - sipas specifikave teknike të detyrueshme 1 njësi, 6. Monitoring software for network - sipas specifikave teknike të detyrueshme 1 njësi, pa marr pëlqimin paraprak nga AShI si dhe nuk kishte prezantuar planin ideor. Kontrata është nënshkruar më 12.12.2019, në vlerë 123,569€, për të cilën ishte bërë edhe pagesa.

Përmes shkresës nr.3341, më 05.11.2019, AShI ka reaguar duke kërkuar të anulohet ky aktivitet i prokurimit për shkak se nuk ka pas njoftim apo kërkesë për shqyrtim të këtij projekti nga MPJ, dhe se AShI mund të ofroj shërbimin pa tela edhe në të gjitha misionet diplomatike nëse kjo kërkohet nga MPJ.

Sipas sqarimeve të ofruara nga Divizioni për Teknologji Informative dhe Logjistike kjo kishte ndodhur për shkak se MPJ për disa vite ka probleme me sistemin e WI-FI që ofrohet nga AShI për ndërtesën e MPJ. Si rrjedhojë, Ministria ka kërkuar përkrahje për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit duke kërkuar edhe rritjen e numrit për Access Points, mirëpo në shumicën e rasteve nuk ka marrë përgjigje. Për më shumë, sipas një komunikimi shihet se MPJ në vitin 2018 kishte kërkuar vendosjen e Access Point, mirëpo përgjigja e AShI ishte se nuk kanë në dispozicion asnjë Access Point. Prandaj, duke i marr parasysh këto vështirësi ministria e kishte planifikuar të realizoj këtë projekt në vitin 2019.

Ndikimi

Koordinimi jo i mirëfilltë mes institucioneve mund të ndikojë në mos ofrimin e shërbimeve të pritura që ndërliken me teknologjinë informative.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të krijoj një grup punues dhe në koordinim me AShI të definojnë qartë se cilat projekte mund të mbulohen nga AShI. Gjithashtu Ministri duhet të sigurojë se në asnjë rast nuk iniciohen projekte të tilla pa plan ideor të dërguar në këtë Institucion.

Çështja A6- Prezantim jo i drejtë i shpenzimeve në pasqyrat financiare

Gjetja Neni 13 dhe 14 i Rregullores MF 01/2017 për Raportim Vjetor të Organizatave Buxhetore kërkon që organizatat buxhetore ta paraqesin totalin e saktë të pagesave.

MPJ në nenin 13 dhe 14 të PFV-ve kishte raportuar shpenzime në shumë prej 30,004,880€ ndërsa sipas SIMFK shpenzimet për vitin 2019 ishin 29,976,909€. Pra ekziston një mbivlerësim i shpenzimeve për 27,971€.

Sipas konfirmimeve të zyrtareve të MPJ-së shumica e shpenzimeve në momentin e përgatitjes së PFV ka qenë e saktë dhe në harmoni me shënimet e SIMFK. Por pastaj ka pas ndryshim të shënimeve në SIMFK nga thesari dhe për këtë nuk ishte njoftuar ministria.

Ndikimi Prezantimi i gabuar i shpenzimeve ndikon që përdoruesit e pasqyrave financiare të mos marrin informata të sakta për shpenzimet të cilat ishin realizuar gjatë vitit fiskal 2019.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet prezantohen me vlerë të saktë në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Çështja A7- Mos anulimi i biletave për udhëtime zyrtare me kohë

Gjetja Neni 16 i Udhëzimit Administrativ nr. MShP 2004/7 për Udhëtimet Zyrtare specifikon se: klasa e lejuar për udhëtime zyrtare me aeroplan është klasa ekonomike. Nëse planet e udhëtimit ndryshojnë pasi të jetë prerë bileta, atëherë institucioni përkatës do të marrë përgjegjësinë për çdo shpenzim shtesë.

Kemi vërejtur se në shtatë raste për biletat e rezervuara për udhëtim me aeroplan, ministria kishte paguar penale kompanisë së udhëtimit në vlerë 2,000€, për shkak se biletat e rezervuara nuk ishin anuluar me kohë nga ministria.

Kjo kishte ndodhur për shkak të papërgjegjësisë së ministrisë për t'i anuluar me kohë biletat e rezervuara.

Ndikimi Pagesa e penaleve për bileta ndikon në dëmtimin e buxhetit të ministrisë dhe rritjen e shpenzimeve.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i udhëtimeve të bëhet me kohë në mënyrë që rezervimi i biletave të mos dështoj dhe që menaxhimi parasë publike të jetë në harmoni me kërkesat ligjore.

Çështja A8- Shpenzimet e biletave klasa biznes**Gjetja**

Neni 16 i Udhëzimit Administrativ nr. MShP 2004/7 për Udhëtimet Zyrtare specifikon se: klasa e lejuar për udhëtime zyrtare me aeroplan është klasa ekonomike. Nëse planet e udhëtimit ndryshojnë pasi të jetë prerë bileta, atëherë institucioni përkatës do të marrë përgjegjësin për çdo shpenzim shtesë.

Ministria kishte paguar katër bileta të udhëtimit me aeroplan në klasën biznes në vlerë 22,184€, edhe pse kjo nuk është e lejuar me udhëzim administrativ. Biletat kanë të bëjë me udhëtimet në destinacione të ndryshme si:

Biletë e udhëtimit për ministrin e MPJ-së në relacionin FRA-IAD (Frankfurt-Uashington) me datë 17.07.2019, në vlerë 6,204€, bileta tjetër për ministrin e MPJ në relacioni IAD- FRA (Uashington- Frankfurt) me datë 19.07.2019 në vlerë 7,879€.

Bileta tjetër me datë udhëtimi 22.07.2019, në relacionin DSS-IST-PRN-IST-DSS (Senegal- Stamboll-Prishtinë dhe anasjelltas) në vlerë 3,518€. Për këtë udhëtim ministria përveç faturës dhe pagesës, nuk ishte në gjendje të na ofroj dokumentet tjera si: ftesën, agjendën, qëllimin e vizitës në Kosovë pasi që ky nuk ishte staf i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Bileta tjetër me datë udhëtimi 03.09.2019, në relacionin JED-IST-ESB-IST-PRN-PRN-IST-LUN në vlerë 4,583€. Për këtë udhëtim ministria përveç faturës dhe pagesës, nuk ishte në gjendje të na ofroj dokumentet tjera si: ftesën, agjendën, qëllimin e vizitës në Kosovë, pasi që ky nuk ishte staf i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Pagesat e bërë për biletat në kategorinë klasa biznes kishin ndodhur për shkak të kërkesave të bëra nga kabineti i ministrit për të rezervuar biletat në klasën biznes pa dhënë ndonjë arsytim.

Ndikimi

Shpenzimet e biletave në klasë biznes rrisin shpenzimet e ministrisë dhe ndikojnë në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi A8

Ministri duhet të siguroj që shpenzimet për biletat e aeroplanit bëhen sipas kërkesave të udhëzimit administrativ në fuqi duke evituar shpenzimet me kosto të lartë pa arsytime.

Çështja B1- Vonesa në regjistrim të shpenzimeve

Gjetja Neni 17 i Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 01/2018, për plotësim dhe ndryshimin e UA nr. 03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në Misione Diplommatike dhe Konsullore (MDK) të Republikës së Kosovës, në lidhje me raportin mujor të shpenzimeve përcakton se të gjitha shpenzimet pasqyrohen në raportin mujor financiar të MDK, i cili i raportohet deri me datën 15 të muajit vijues departamentin për buxhet dhe financa në ministri. MDK-të janë të obliguara të respektojnë Rregullën financiare 01/2013 gjatë përgatitjes së raportit nëntëmujor dhe vjetor.

Gjatë testimeve, ne kemi vërejtur se në disa raste kishte vonesa në raportimin e shpenzimeve nga MDK-të mbi afatin kohor prej 15 ditësh. Disa nga shkaqet e kësaj gjendje kanë të bëjnë me vonesat në raportim nga MDK-të, nevoja për informata shtesë për arsyetim të shpenzimeve nga MDK-të, etj.

Ndikimi Vonesat në regjistrimin e shpenzimeve ndikojnë që raportimet tremujore të jenë të pasakta, pasi ato nuk e tregojnë gjendjen e saktë të shpenzimeve të ndodhura. Kjo rrit rrezikun që shpenzimet e caktuara të mos përfshihen edhe në PFV.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike, përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informatat e sakta për të gjitha transaksionet financiare.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 50,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 5,500€ si një pagesë e vetme. Nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 815,000€. Prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 673,243€. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e veturave zyrtare dhe renovim të objekteve konsullore. Kemi testuar 7 mostra për teste substanciale në vlerë 436,901€ ndërsa 2 procedura të prokurimit për pajtueshmëri në vlerë 246,561€. Auditimi ynë ka identifikuar dobësinë në vijim:

Çështja A9- Pagesa jo në harmoni me kushtet e kontratës dhe mungesë e komisionit të pranimit**Gjetja**

Te kontrata për “Renovimin e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Shqipëri” e lidhur me 23.11.2018 në vlerë 29,749€ ishin paraparë punimet sipas specifikacionit (preventivë punimesh) që do të kryhen për renovime. Ne gjatë auditimit të pagesave që ndërlidhen me këtë projekt kemi vërejtur se disa artikuj ishin faturuar dhe paguar derisa ata artikuj nuk kishin qenë pjesë e specifikacionit teknik të çmimeve. Vlera e këtyre artikujve të paguar që nuk ishin pjesë e kontratës ishte 2,053€. Për më shumë, situacionet e kryerjes së punimeve nuk ishin të nënshkruara nga menaxheri i projektit apo nga ndonjë komision i pranimit.

Kjo ka ndodhur për shkak dështimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm me rastin e certifikimit të pagesës nga certifikuesi si dhe dështimit të mbikqyrjes së projektit.

Ndikimi

Pagesa e artikujve që nuk kanë qenë pjesë e kontratës përveç që është në kundërshtim me kushtet e kontratës mund të ndikoj që punimet të mos jenë të kualitetit të pritur si dhe të mos merret vlera për parën e shpenzuar.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të siguroj që të respektohen në përpikëri kontratat e punës me operatorët ekonomik duke u furnizuar vetëm me artikuj të cilët janë paraparë me kontratë, në mënyrë që të evitohen pagesa të cilat nuk kanë çmime të dakorduara paraprakisht.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Raportin Vjetor Financiar (RVF) e pasurive kapitale është 3,112,380€, e pasurive jokapitale është 1,318,217€ si dhe e stoqeve 92,965€. Kemi testuar 22 mostra për testim substancial në vlerë 276,612€. Në aspektin e pajtueshmërisë kemi vlerësuar nëse ministria ka vepruar në pajtim me kërkesat e rregullores për pasuri. Çështjet që kanë rezultuar nga auditimi janë të përshkruar më poshtë.

Çështja A10- Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF – Nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare përcakton se çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu paragrafi 3 i kësaj rregullore përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Kemi identifikuar se 12 iPhone 8, dhe 10 Samsung S8 nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive të ministrisë. Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtari i pasurive nuk kishte dokumentacion për këto pasuri dhe nuk ishte i informuar për pranimin dhe ngarkimin e këtyre pasurive nga logjistika.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive mund të ndikojë që pasuritë e ministrisë të humbin apo keqperdoren dhe rrjedhimisht vlera e pasurive të mos prezentohet e plotë dhe e saktë në RVF.

Rekomandimi A10 Ministri duhet të sigurojë që në momentin e blerjes dhe pranimit të pasurive, sigurohet dokumentacioni adekuat dhe të njëjtat regjistrohen në regjistrat përkatës sipas kërkesës së rregullores në fuqi.

Çështja B2 Mos raportim i pasurisë nga Misionet diplomatike dhe Konsullore

Gjetja Neni 19.3.2-Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€ dhe Neni 19.3.3 Stoqet i RVF kërkon që pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet të prezantohen në vlera të plota dhe të sakta.

Nga testimet tona kemi gjetur se disa nga Misionet Diplommatike dhe Konsullore (MDK) nuk kishin raportuar për pasuritë nën 1,000€ në fund të vitit 2019 dhe si rrjedhojë pasuritë e këtyre MDK-ve nuk ishin raportuar në RVF e vitit 2019. MDK që nuk kishin raportuar për pasuritë nën 1,000€ ishin: Konsullata në Hamburg-Gjermani, Ambasada e Kosovës në Japoni, Ambasada e Kosovës në Tiranë dhe Zyra ndërlidhëse në Serbi.

Rastet e mos raportimit për pasuritë nën 1,000€ nga institucionet e lartcekura ndikojnë që vlera e pasurive në RVF e vitit 2019 të mos jetë e plotë dhe e saktë.

Kjo kishte ardhur si rezultat i neglizhencës nga ana e MDK-ve edhe përkundër kërkesave që kishin bërë zyrtarët nga zyra e financave të MPJ-së lidhur me raportimin e pasurive në ministri.

Ndikimi Dobësitë në menaxhim dhe raportim të pasurive me theks të veçantë nga MDK-të, janë indikatorë të mungesës së kontrollit mbi pasuritë, pengojnë menaxhimin efektiv dhe rrisin rrezikun e humbjes apo tjetërsimit të pasurisë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj që zyrtarët kompetent nëpër MDK të bëjnë raportimin e pasurive në kohën e duhur në mënyrë që pasuritë në RVF të prezantohen në vlerën e plotë dhe të saktë.

2.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Pasqyra e avanceve të hapura të prezantuara në RVF në fund të vitit 2019 ishte 274,476€. Ne kemi testuar 23 mostra të auditimit në vlerë 227,974€. Çështjet lidhur me avancet janë shpалosur në vijim:

Çështja A11- Përdorim i pa autorizuar i kartelës kreditore**Gjetja**

Neni 19 paragrafi 6 i Rregullores MF- Nr. 02/2018 për Përdorim të Kartelës Kreditore për Udhëtime Zyrtare, përcakton se: “Organizata buxhetore është përgjegjëse që ta njoftojë sa më shpejtë që është e mundur me shkrim Thesarin për rastet kur mbajtësi i kartelës kreditore ka ndërprerë ose pezulluar marrëdhënien e punës në mënyrë që kartela kreditore të bllokohet”. Po ashtu, neni 20 paragrafi 5 përcakton se: “Mbajtësi i kartelës kreditore njofton organizatën buxhetore me kohë nëse do të shkëpus apo pezullojë marrëdhënien e punës, në mënyrë që të përfundojë autorizimi i mbajtjes së kartelës kreditore”.

Ne kemi vërejtur se në një rast ministria nuk kishte njoftuar thesarin për zyrtarin (zëvendës ministër) që i kishte përfunduar mandati në mënyrë që kartela kreditore të bllokohet. Po ashtu, as mbajtësi i kartelës kreditore nuk kishte njoftuar organizatën buxhetore për përfundimin e mandatit. Si rezultat kartela kreditore ishte përdorur nga zëvendës ministri edhe pas përfundimit të mandatit (08.09.2017) deri me 18.09.2019. Sipas raportit të shpenzimeve shihet që përdorimi i kartelës kreditore ishte bërë për pagesën e shpenzimeve personale dhe jo për udhëtime zyrtare siç parashihet në rregulloren e përdorimit të kartelës kreditore. Edhe pse zyrtari në fund të muajt i ka deponuar mjetet në bankë për shpenzimet e bëra me kartelë kreditore, MPJ në fund të vitit 2019 nuk kishte qenë në gjendje t'i mbyllë avance në thesar (4,263€) të cilat figurojnë si të hapura.

Kjo ka ndodhur nga papërgjegjësia e ministrisë dhe mbajtësit të kartelës për të kërkuar bllokimin e kredit kartelës.

Ndikimi

Përdorimi i kartelës kreditore pas përfundimit të mandatit përveç që është në kundërshtim me kërkesat rregullore paraqet rrezik të keqpërdorimit të parasë publike.

Rekomandimi A11 Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje të vazhdueshme në mënyrë që pas përfundimit të mandatit të zyrtarëve të kërkoj mbylljen e kartelës kreditore. Po ashtu të merr të gjitha masat që të bëhet mbyllja e këtyre avanceve në thesar.

Çështja B3 Mos arsyetim në kohë i shpenzimeve me kartelë kreditore

Gjetja

Neni 9 paragrafi 4 Rregullores MF- Nr. 02/2018 për Përdorimin e Kartelës Kreditore për Udhëtime Zyrtare përcakton se: Në rast se mbajtësi i kartelës kreditore nuk i posedon faturat që kërkohen për shpenzimet e lejuara me kartelë kreditore, që i përkasin udhëtimit zyrtar të autorizuar, zyrtarët e organizatave buxhetore mund të mbyllin avancin me arsyetimin e shpenzimeve duke u bazuar në raportin e kreditorit, deklaratën me shkrim të mbajtësit të kartelës kreditore lidhur me shpenzimin e mungesën e faturës, pas një analize të hollësishme dhe verifikimeve të nevojshme.

Po ashtu neni 11 paragrafi 2 e Rregullores MF- Nr. 02/2018 – Pagesa e shpenzimeve të obligimeve të paautorizuara, përcakton që: "Shpenzimet e paautorizuara janë përgjegjësi e mbajtësit të kartelës kreditore, të cilat duhet të kompensohen nga mbajtësi i kartelës kreditore brenda afatit tridhjetë (30) ditësh dhe neni 3 përcakton: në rast të mos pagesës së paraparë OB i kompenson këto mjete nga paga ose përfitime tjera të mbajtësit të kartelës kreditore.

Gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Një nga këshilltarët e ministrit për muajt tetor dhe nëntor 2019, kishte bërë shpenzime në vlerë 6,876€ përmes kartelës kreditore. Ne kemi identifikuar se nga totali i shpenzimeve të bëra, zyrtari nuk e kishte arsyetuar vlerën 4,168€ të tërhequr në para të gatshme, me ç'rast avanci ka mbetur i hapur në fund të vitit 2019. Për më shumë, MPJ nuk kishte ndërmarr veprime konkrete lidhur me ndaljen e mjeteve nga paga mujore ashtu siç kërkohet në rregulloren. Vlen të theksohet që sipas shënimeve të ministrisë zyrtari më datën 07.02.2020 i kishte kthyer paratë në bankë (4,168€).

Një zyrtar (zëvendës ministër) kishte bërë shpenzime për periudhat mars, maj, qershor, gusht dhe shtator përmes kredit kartelës në vlerë 6,025€, ku nga totali i shpenzimit, 551€, kishin qenë shpenzime të pa autorizuara (shpenzime të cilat nuk lejohen të bëhen përmes kartelës kreditore). Ministria nuk kishte ndërmarr veprime konkrete lidhur me ndaljen e mjeteve nga paga mujore ashtu siç kërkohet në rregulloren dhe si rezultat avanci ka mbetur i hapur në fund të vitit. Vlen të theksohet se me datën 30.01.2020 zyrtari i kishte kthyer mjetet.

Më tutje, përveç kësaj i njëjti zyrtar për periudhat korrik, tetor dhe nëntor përmes kartelës kreditore kishte shpenzuar 10,311€, ku përveç raportit bankar zyrtari në fjalë nuk kishte sjellë faturat për të arsyetuar shpenzimet e bëra më ç'rast në fund të vitit avanci kishte mbetur i hapur dhe i raportuar në RVF.

Shkaku i mos arsyetimit të shpenzimeve ishte pa përgjegjësia e përdoruesve të kartelës kreditore për ta përdorur kartelën kreditore sipas rregullativës ligjore si dhe neglizhenca e ministrisë në monitorimin dhe veprimin në pajtim me rregulloren në fuqi.

Më tutje, neni 7 i Rregullores MF- Nr. 02/2018 për përdorimin e kartelës kreditore për udhëtime zyrtare përcakton se: Çdo mbajtës i kartelës kreditore, me rastin e pajisjes me kartelë kreditore, nënshkruan një marrëveshje me organizatën buxhetore me të cilën autorizon organizatën buxhetore që të tërheqë shpenzimet e paautorizuara të realizuara me kartelë kreditore nga paga dhe nga kompensimet tjera të mbajtësit të kartelës kreditore.

Kemi vërejtur se ministria për rastet e përmendura më lartë nuk kishte bërë marrëveshje me përdoruesit e kartelës kreditore ashtu siç kërkohet në rregulloren përkatëse.

Ndikimi

Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve dhe mos-mbyllja e avanceve me kohë, mund të ndikojë që paratë publike të keqpërdoren dhe të mos arrihen qëllimet e synuara.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të siguroj që përdoruesit kartelës kreditore të përdorin kartelën për qëllime zyrtare dhe të siguroj se shpenzimet arsyetohen me fatura si dhe në rastet kur shpenzimet janë të pa autorizuara (jo në harmoni me kërkesat e rregullores) të aplikohen ndalesa në pagë apo kompensime tjera të përdoruesit të kartelës për të kompensuar shpenzimet e pa autorizuara. Po ashtu Ministri të sigurojë se me të gjithë përdoruesit e kartelave kreditore janë lidhur marrëveshjet të cilat e autorizojnë Ministrinë të tërheqë shpenzimet e paautorizuara nga paga e zyrtarit.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 ishte 231,620€. Detyrimet e pa paguara më shumë se 30 ditë ishin 219,641€, ndërsa ato me pak se 30 ditë 11,979€. Këto detyrime përbëhen nga: mallra dhe shërbime 226,405€ dhe shpenzime kapitale 5,215€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Ne kemi testuar 7 mostra të auditimit në vlerë 9,191€ mirëpo nuk kemi ndonjë çështje për të raportuar.

Ndërsa për obligimet kontraktuale sipas shënimeve të MPJ në fund të vitit 2019 ishin 311,824€ dhe ato pritet të realizohen në vitet vijuese.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në MPJ operon me tre (3) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor.

NjAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë disa fusha rishikimi për vitin 2019. Plani vjetor ishte i bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe prioriteteve. Ky plan përfshinte gjithsej shtatë (7) auditime përfshirë një me kërkesë. Në vitin 2019 NJAB kishte përmbushur në tërësi planin e auditimit. NJAB kishte kryer raportimet e rregullta në NJQHAB. Gjatë vitit 2019, duke ju referuar raportimit vjetor në NJQHAB, ishin dhënë 31 rekomandime ku prej tyre 12 ishin zbatuar, 10 ishin në proces të zbatimit dhe nëntë (9) nuk ishin zbatuar.

Komiteti i auditimit (KA) kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2019 ku ishin shqyrtuar në vazhdimësi raportet e NJAB-së dhe po ashtu Komiteti i Auditimit kishte hartuar raportin vjetor.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të MPJ-së ka rezultuar me 10 rekomandime. MPJ kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Po ashtu, MPJ me datën 09.10.2019 kishte përgatitur raportin periodik për zbatim të rekomandimeve të cilat kanë rezultuar nga raporti i auditimit të vitit të kaluar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, pesë rekomandime janë zbatuar, katër nuk janë adresuar ende, një rekomandim është pjesërisht i zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet adekuate për t'i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paregjistruara që po përsëriten vit pas viti. Po ashtu Ministri duhet të sigurojë që e gjithë pasuria e blerë të regjistrohen në regjistra, dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta në lidhje me pasuritë. Veç kësaj, Ministri duhet të sigurojë që për të gjitha shënimet e prezantuara ne PFV, do të bëhen shpjegime sqaruese, në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për shfrytëzuesit e tyre. Avancet e pa arsyetuara duhet të prezantohen me vlera të sakta dhe të jepen shpjegimet e nevojshme për to.	Megjithëse vërehet një përmirësim i lehtë, përsëri janë shfaqur raste të shpenzimeve të paregjistruara dhe avanceve të pa arsyetuara.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për mosrealizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ulët të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Planifikimi i buxhetit duhet të harmonizohet me projektet e gatshme për realizim dhe procedurat e prokurimit të iniciohen me kohë dhe në pajtim me alokimet buxhetore.	Ministria ka arritur ta shpenzojë buxhetin 96% si dhe projektet kapitale ishin realizuar.	Rekomandim i zbatuar.
3	Çështja B2 – Vonesa në regjistrimin e të hyrave	Ministri duhet të rris nivelin e përgjegjësisë tek shefat e MDK-ve dhe stafi tjetër përgjegjës, për të siguruar raportime të rregullta dhe me kohë, në lidhje me të hyrat e realizuara, në mënyrë që ato të regjistrohen me kohë në SIMFK si dhe të raportohen sakte në raportet periodike dhe në PFV.	Edhe në vitin 2019 kemi hasur raste të raportimit dhe regjistrimit me vonesë. Kjo çështje është e raportuar tek letër-menaxhmenti	Rekomandim i pa zbatuar

4	Pagat dhe Mëditjet-Çështja C2 – Mbjajtja e pozitës së Ambasadorit pas mandatit katër vjeçar, pa vendim për zgjatjen e mandatit.	Ministri duhet t'i shqyrtoi rastet e tilla dhe të siguroi që personeli diplomatik përfshirë edhe ambasadorët, posedojnë bazën e duhur ligjore për veprim në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi në misionet diplomatike, konform Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.	Nuk kemi hasur ndonjë problematikë të natyrës së njëjtë. Në mostrën tonë është vërejtur se vazhdimi i detyrës së ambasadorit ishte bërë më dekret të Presidentit pas propozimit të Ministrit.	Rekomandim i zbatuar
5	Çështja B3 – Vonesa në regjistrimin e shpenzimeve.	Ministri duhet të siguroi zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike, përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informatat e sakta për të gjitha transaksionet financiare.	Edhe në vitin 2019 kemi vërejtur raste të raportimit dhe regjistrimit me vonesë të shpenzimeve të misioneve diplomatike.	Rekomandim i pa zbatuar
6	Çështja A1 – Përfshirja e devijimit prej +/- 30% në kontratën me çmime të peshuara.	Ministri duhet të siguroi që personat përgjegjës të prokurimit i kuptojnë saktë kërkesat e legjislacionit në lidhje me prokurimin dhe kontratat, në mënyrë që kontratat të përpilohen në përputhje me rregullat e aplikueshme dhe të mos përfshihen elemente që në të ardhmen mund të shkaktojnë dëme financiare për Ministrinë.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje të natyrës së njëjtë.	Rekomandim i zbatuar
7	Çështja A2 – Tejkallim i afatit të paraparë për vlerësimin e ofertave.	Ministri duhet të siguroi se komisionet vlerësuese me përkrahjen e departamentit të prokurimit i kryejnë vlerësimet e ofertave brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që shërbimet e kërkuara të merren me kohë si dhe të sigurohet një proces sa më transparent.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje të natyrës së njëjtë.	Rekomandim i zbatuar
8	Çështja A3 – Keq klasifikimi i shpenzimeve ekonomike	Ministri nëpërmjet personave përgjegjës duhet të siguroje se me rastin e planifikimit të buxhetit, shpenzimet të planifikohen në kategorinë adekuate ekonomike sipas planit kontabël, në mënyrë që edhe realizmi i shpenzimeve dhe	Nuk kemi hasur ndonjë çështje të natyrës së njëjtë.	Rekomandim i zbatuar

		raportimi i tyre në PFV të jetë i sakte dhe korrekt.		
9	Çështja B4 – Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive.	Ministri nëpërmjet personave përgjegjës duhet të siguroi funksionimin e mekanizmave të kontrollit në fushën e menaxhimit të pasurive, në mënyrë që të menaxhohen në pajtim me rregullat dhe regjistrat e pasurive të ofrojnë informatat e sakta dhe të plota për pasuritë në dispozicion.	Edhe për vitin 2019 është vërejtur problematika e njëjtë sa i përket çështjes së pasurive.	Rekomandim i pazbatuar
10	Trajtimi i parasë se gatshme dhe ekuivalentë ve të saj- Çështja A4 – Mangësi në menaxhimin e avanceve, mos arsyetimin e shpenzimeve të udhëtimit, dhe avancet e pambyllura	Ministri duhet të siguroi se në të gjitha rastet kur zyrtarët nuk i kanë arsyetuar shpenzimet e udhëtimit në pajtim me rregullat, shumat e paarsyetuara t'u ndalen nga pagat. Kjo do të ndikoi në rritjen e përgjegjësisë së stafit në kryerjen e obligimeve ligjore për arsyetimin e shpenzimeve dhe mbylljen e avanceve në pajtim me rregullat në fuqi.	Edhe në vitin 2019 kemi hasur në çështje të njëjta sa i përket avanceve.	Rekomandim i pazbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Emërimi i Konsujve në Misione Diplomatike konsullore pa konkurs të hapur	Ministri duhet të siguroj që me rastin e emërimit të përfaqësuesve në Misione diplomatike konsullore, pranimi të bëhet përmes konkursit të hapur duke respektuar gjithashtu edhe kërkesën ligjore për gradimin e anëtarëve që hyjnë në shërbimin e jashtëm.		
A2	Pranimi i konsujve me vendim të ministrit jo në pajtim me kërkesat ligjore	Ministri duhet të siguroj që me rastin e emërimit të përfaqësuesve në Misione diplomatike konsullore, të respektohen rregullat e procesit të gradimit.		

A3	Mbulimi i shpenzimeve shëndetësore në mungesë të marrëveshjes për sigurim shëndetësor	Ministri duhet të sigurojë se të gjithë të akredituarit diplomatik, pajisen me polisa të sigurimeve shëndetësore. Për rastet ku mund të krijohen vonesa deri në nënshkrimin e një kontrate, duhet të hartohet një akt nënligjor i cili definon qartë se deri në çfarë vlere/norme mund të mbuloen shpenzimet shëndetësore nga buxheti i shtetit.
A4	Mbulimi i shpenzimeve për renovime të banesave	Ministri duhet të krijoj një komision i cili vlerëson se cilat nga shpenzimet e mësipërme janë bërë nga moskujdesi i diplomatit dhe për të njëjtat duhet t'i bëhen ndalesat në pagë. Në ato raste ku Ministria vlerëson se duhet patjetër të paguajë për renovime, atëherë këtë duhet ta bëjë vetëm nëse harton akt nënligjor ku përcaktohet qartë se deri në çfarë shkalle dhe cilat shpenzime mund të konsiderohen si të domosdoshme për mbulim nga paraja publike.
A5	Furnizim me pajisje të IT pa pëlqim të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (AShI)	Ministri duhet të krijoj një grup punues dhe në koordinim me AShI të definojnë qartë se cilat projekte mund të mbuloen nga AShI. Gjithashtu Ministri duhet të sigurojë se në asnjë rast nuk iniciohen projekte të tilla pa plan ideor të dërguar në këtë Institucion.
A6	Prezantim jo i drejtë i shpenzimeve në pasqyrat financiare	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet prezantohen me vlerë të saktë në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.
A7	Mos anulim i biletave për udhëtime zyrtare me kohë	Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i udhëtimeve të bëhet me kohë në mënyrë që rezervimi i biletave të mos dështoj dhe që menaxhimi parasë publike të jetë në harmoni me kërkesat ligjore.
A8	Shpenzimet e biletave klasa biznes	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet për biletat e aeroplanit bëhen sipas kërkesave të udhëzimit administrativ në fuqi duke evituar shpenzimet me kosto të lartë pa arsye.

B1	Vonesa në regjistrim të shpenzimeve	Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike, përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informatat e sakta për të gjitha transaksionet financiare.
A9	Pagesa jo në harmoni me kushtet e kontratës dhe mungesë e komisionit të pranimit	Ministri duhet të siguroj që të respektohen në përpikëri kontratat e punës me operatorët ekonomik duke u furnizuar vetëm me artikuj të cilët janë paraparë me kontratë, në mënyrë që të evitohen pagesa të cilat nuk kanë çmime të dakorduara paraprakisht.
A10	Dobësi në menaxhimin e pasurisë	Ministri duhet të sigurojë që në momentin e blerjes dhe pranimit të pasurive, sigurohet dokumentacioni adekuat dhe të njëjtat regjistrohen në regjistrat përkatës sipas kërkesës së rregullores në fuqi.
B2	Mos raportim i pasurisë nga Misionet diplomatike dhe Konsullore	Ministri duhet të siguroj që zyrtarët kompetent nëpër MDK të bëjnë raportimin e pasurive në kohën e duhur në mënyrë që pasuritë në RVF të prezantohen në vlerën e plotë dhe të saktë.
A11	Përdorim i pa autorizuar i kartelës kreditore	Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje të vazhdueshme në mënyrë që pas përfundimit të mandatit të zyrtarëve të kërkoj mbylljen e kartelës kreditore. Po ashtu të merr të gjitha masat që të bëhet mbyllja e këtyre avanceve në thesar.
B3	Mos arsyetim në kohë i shpenzimeve e me kartelë kreditore	Ministri duhet të siguroj që përdoruesit kartelës kreditore të përdorin kartelën për qëllime zyrtare dhe të siguroj se shpenzimet arsyetohen me fatura si dhe në rastet kur shpenzimet janë të pa autorizuara (jo në harmoni me kërkesat e rregullores) të aplikohen ndalesa në pagë apo kompensime tjera të përdoruesit të kartelës për të kompensuar shpenzimet e pa autorizuara. Po ashtu Ministri të sigurojë se me të gjithë përdoruesit e kartelave kreditore janë lidhur marrëveshjet të cilat e autorizojnë Ministrinë të tërheqë shpenzimet e paautorizuara nga paga e zyrtarit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspora / Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Shkelzen Morina

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Data: 04.08.2020, Prishtinë

